



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:**

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Udhëheqës i Divizionit për Trajnime dhe Zhvillim të Kurikulave,**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel drejtues, koeficienti 9,**

Nr. i ref : **AKSP-6/2012,**

Raporton të: **Drejtori i Departamentit për Trajnime dhe Përkrahje Programore,**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore,

1. Mbikëqyrë, menaxhon dhe koordinon punët brenda Divizionit të Trajnimeve dhe Zhvillim të Kurikulave,
2. Propozon politikat zhvillimore të Divizionit dhe dorëzon raportet për planifikimet vjetore,
3. Menaxhon burimet e nevojshme për të siguruar që të gjitha aktivitetet e divizionit të realizohen në mënyrë efektive dhe efikase në të gjitha aspektet,
4. Mbikëqyr dhe koordinon punën lidhur me proceset e zhvillimit të kurikulave (standardizim, dizajnin, formatizim, azhurnim, etj) për të gjitha materialet e trajnimit në AKSP,
5. Mbikëqyr dhe koordinon punën lidhur me proceset e testimit për të gjitha trajnimet në AKSP,
6. Mbikëqyr dhe koordinon punën lidhur me proceset mbështetëse që kanë të bëjnë me armëtar dhe multimedia,
7. Bashkërendimi dhe ndërlidhja e punëve sipas nevojës me Agjencionet e Sigurisë Publike në AKSP,

8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Drejtori i Departamentit për Trajnime dhe Përkrahje Programore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë te drejtë te punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi te plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Trajnime dhe Zhvillim të Kurikulave, procedura e konkurrimit është e hapur (për gjithë të interesuarit).

Shkollimi i kërkuar

- Përgatitje Universitare (e obligueshme).

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point), fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor e nevojshme. Së paku katër (4) vite përvojë pune, duke përfshi një (1) vit përvojë pune në vende udhëheqëse (e obligueshme). Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme). Njohja e gjuhës angleze (përparësi).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve dhe Zhvillimit të Kurikulave, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve dhe Zhvillimit të Kurikulave, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës).

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 25.05.2012 deri me datën 08.06.2012.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, ndërtesa e re administrative Vushtrri, ose nëpërmjet adresës elektronike: habbije.cakiqi@rks-gov.net, Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.